

Kryetari i komunës së Bogovinës në bazë të nenit 50 të Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.5/02), dhe në lidhje me nenin 126 paragrafit (1) të Ligjit për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16 dhe 99/18), duke vendosur sipas kërkesës për marrjen e lejes ekologjike B të integruar nr. 11-3322/1 nga 23.11.2022 vit të instalimit të një Baze Betoni DMTTU BULA TRANS DOOEL- Zherovjan komuna e Bogovinës, solli:

(propozim)

#### V E N D I M

1. Lëshohet Propozim leja ekologjike B e integruar për instalimin e bazës së betonit DMTTU BULA TRANS DOOEL- Zherovjan komuna e Bogovinës.
2. Kërkohet instalimi i një baze betoni DMTTU BULA TRANS DOOEL- Zherovjan komuna e Bogovinës të veproj në përputhshmëri me kushtet dhe obligimet e definuara në këtë leje.
3. Leja ekologjike B e integruar do të publikohet në shtypin ditor , në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e publikimit, në shpenzim të kërkuarit.

#### ARSYETIM

Instalimi i Bazës së Betonit DMTTU BULA TRANS DOOEL- Zherovjan komuna e Bogovinës (më tej: kërkuarisi), deri tek kryetari i komunës së Bogovinës solli kërkesë për marrjen e lejes ekologjike B të integruar nr. 11-3322/1 në ditën 23.11.2022 vit (më tej: kërkesë). Aplikanti kryen një veprimtari: - bazë betoni – prodhimin e betonit të gatshëm të destinuar për ndërtim, me kapacitet të projektuar nga 60 m<sup>3</sup>/h kub e cila në pajtueshmëri me nenin 122 të Ligjit për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16 dhe 99/18), dhe dekretit për përcaktimin e veprimtarive të instalimit për të cilat jepet leja ekologjike e integruar gjegjësisht leje për përputhje me planin operativ dhe orarin kohor për paraqitjen e kërkesës për leje për përputhshmëri me planin operativ ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.89/05), duhet patjetër të merr lejen ekologjike B të integruar.

Organi kompetent pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë përpiloi një përllogaritje dhe i dorëzoi kërkuarisi një urdhërpagesë të kompensimit që do e bëj gjatë parashtrimit të kërkesës për marrjen e lejes ekologjike B të integruar nr. 11-3322/1 në ditën 23.11.2022 vit, shuma e kompensimit ishte përllogaritur në përputhshmëri me Dekretin mbi masën e kompensimit të cilën duhet ta paguajnë operatorët e instalimeve të cilët kryejnë aktivitete për lejen ekologjike B të integruar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.117/07, 64/10 dhe 186/16).

Organi kompetent pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar përcaktoi se e njëjta është përpiluar në përputhshmëri me formën e përshkruar dhe përmbajtjen në Rregulloren për

procedurën për marrjen e lejes ekologjike B të integruar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.112/14 dhe 42/16), dhe në lidhje me nenin 124 nga Ligji për mjedisin jetësor.

Kërkesa e plotë u publikua në shtypin ditor dhe në ueb faqen e komunës së Bogovinës.

Në ditën 25.11.2022 vit, është kryer një inspektim i instalimit nga ana e personit të autorizuar nga organi kompetent në përputhshmëri me nenin 9 të Rregullores për procedurën për marrjen e lejes ekologjike B të integruar, gjatë të cilit është përpiluar procesverbal për inspektim të kryer nr.11-3322/2 nga 28.11.2022 vit me të cilin është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes ekologjike B të integruar.

Organi kompetent në bazë të kërkesës së plotë, pas mbarimit të procedurës në tërësi dhe në përputhshmëri me kompetencat që dalin nga neni 123 paragrafi (1) dhe nenit 126 paragrafit (1) nga Ligji për mjedisin jetësor, përcaktoi se kërkuuesi i përmbush kushtet për marrjen e lejes ekologjike B të integruar.

Leja ekologjike B e integruar do të publikohet në ueb faqen e komunës së Bogovinës dhe në një gazetë ditore që është në dispozicion në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e publikimit, gjatë së cilës publikimi në gazetën ditore është në shpenzimin e kërkuuesit, dhe në përputhshmëri me nenin 113 dhe nenin 122 paragrafi (4) të Ligjit për mjedisin jetësor.

Duke u bazuar në atë më sipër organi kompetent vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

UDHËZIM LIGJOR: Sipas nenit 126 paragrafit (2) të Ligjit për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16 dhe 99/18), kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë në formë të shkruar deri tek Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në Shkallën e dytë, në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të vendimit.

Komuna e Bogovinës

Kryetar

Besnik Emshi



Dorëzuar në:

- Arkivin e komunës së Bogovinës
- DMTTU BULA TRANS DOOEL
- Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor